



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0036983/2/24 dt. 06.06.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0036983/24, dt. 31.05.2024 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. Formohet Grupi Punues për Hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Arian Tahiri – kryesues, (Nënkryetar i Komunës);
 - 1.2. Vesa Broja – anëtare, (Kryesuese e Kuvendit Komunal);
 - 1.3. Besa Veseli – anëtare, (Zyrtare për Barazi Gjinore);
 - 1.4. Igballe Islami – anëtare, (Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa);
 - 1.5. Zenel Çitaku – anëtar, (Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa);
 - 1.6. Drita Ibrahim – anëtare, (Drejtoreshë e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale);
 - 1.7. Fahri Jashari – anëtar, (Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport);
 - 1.8. Adem Fazliu – anëtar, (Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim Ekonomik);
 - 1.9. Ferdi Kadriu – anëtar, (Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural);
 - 1.9. Sadije Jashari – anëtare, (Zyrtare për Integritet Evropian);
 - 1.10. Refik Azemi – anëtar, (Udhëheqës i Sektorit për Arsim);
 - 1.11. Albana Fejza – anëtare, (Drejtoria për Shëndetësi)
 - 1.12. Blerina Haxhi Kastrati – anëtare, (Udhëheqëse e Njesisë për Komunikim me Publikun);
 - 1.13. Teuta Selmani – anëtare, (Zyra Ligjore).
2. Grupi punues i lartcekur obligohet të bëjë Hartimin e Draft – Planit Komunal për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
3. Grupi Punues obligohet që pas Hartimit të Draft – Planit të lartcekur të njëjtin ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes Kryetarit të Komunës.



4. Grupi Punues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0036983/24, dt. 31.05.2024 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kërkesa elektronike e dt. 04.06.2024 nga znj. Igballë Islami - Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve Grupit Punues
- 1x1 Arkivit